



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

## Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 04.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (parografi 10) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (parografi 1) të Rregullës për Parashtimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.03.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " U - UNIQUE " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari" me Nr. të Prok: 651-23-2715-5-2-1, mori këtë:

### VENDIM

Aprovohet pjesërishtë- si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik " U - UNIQUE " SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari" me Nr. të Prok: 651-23-2715-5-2-11, dhe

Njoftimi për Kontratë e AK-së, të datës 27.03.2023.

Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e dosjes së tenderi, duke e korigjuar në harmoni me LPP dhe po ashtu do të vazhdohet me ketë aktivitet .

Ky vendim hyn në fuqi ditën e njëshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

### Arsyetim

Operatori ekonomik " U - UNIQUE " SH.P.K., si palë e pakënaqur me datë 31.03.2023 ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues të Komunës së Gjilanit kundër Njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore të elektrikës në rr. Adem Jashari" me Nr. të Prok: 651-23-2715-5-2-1 dhe me pretendimin se AK ka vepruar në kundërshtim të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitur në Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruesit, shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit dhe analizës konkrete në mënyrë të drejtë të gjitha fakteve dhe provave të administruara, gjeti dhe konstatoi se Kërkesat për Rishqyrtim të parashtruesve aprovohen si pjesërishtë të bazuara.

#### Pretendimi ankimor i parë :

Në pikën 5.2 të dosjes së tenderit nga ana juj është përcaktuar që afatet kohore për realizimin dhe përfundimin e kontratës janë një muaj që nënkupton 20 ditë pune.

Afati përcaktuar nga ana e juaj bazuar në punët e parashikuara në paramasë për realizimin e projektit nuk përputhet me gjendjen faktike dhe rrëthanat faktike p[ër realizimin e projektit. Ju e dini se rruga ku planifikohet të kryhen punët është është mu në qendër të qytetit, është arterie për lidhjen e shumë pjesëve të qytetit dhe ndër rrugët më te frekuentuara. Po ashtu nga ana e aspektit ekonomik përskaj dy anëve të kësaj rruge ndodhen veprimtari të ndryshme ekonomike të biznesit. Të gjitha këto biznese dhe shtëpitë e banimit duhet të kyqen vec e vec në rrjetin nëntokësor elektrik. Janë 17883 metra gjatësi të gypave që duhet të vendosen dhe të kyqen të gjithë këta banorë dhe biznese. Ku është mbështetur analiza dhe logjika e juaj që për një muaj apo 20 ditë pune të realizohet ky projekt me të gjitha këto specifika dhe rrëthana komplekse.

Prandaj kërkojmë nga AK që ky afat të korrigojhet dhe të venndoset një afat i ri në pajtueshmëri dhe duke ju përshtatur specifikave dhe rrëthanave faktike të rrugës ku planifikohet të kryhen punimet siç u potencuan më lartë me qëllim që projekti të mos të dshtojë por te realizohet me sukses.

#### Përgjigje në pretendimin ankimor pika e parë :

*Duke u bazuar në kërkesën e juaj për zgjatjen e afatit për realizimin e punimeve që nuk është e mjaftueshme periudha prej 20 ditëve të punës dhe me qëllim që projekti të mos të dështojë por te realizohet me sukses, atëherë shtyerja e afatit për realizimin e punëve shtyhet edhe për 15 ditë të tjera e që I bie që ditë punë të jenë përafërsishtë 30 ditë.*

*Dhe ky afat I kufizuar është për shkak se kjo rrugë siq e keni cekur është e ngarkuar me qarkullim dhe po ashtu funksionojnë shumë biznese dhe kemi menduar se punimet duhet të kryhen në një periudhë të shkurtër kohore dhe me një intsitet të lartë të punimeve.*

#### Pretendimi ankimor i dytë :

Sipas nenit 13.1 të Rregullorës për Prokurim Publik përcaktohet se parallogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar. Ndërsa në 13.3 përcaktohet taksativisht se në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim.

Në rastin konkret AK vlerën e parashikuar të kontratës prej 187,049.13€ nuk e ka përcaktuar sipas vlerës reale dhe analizës financiare bazuar në çmimet relevante në tregun aktual të materialit dhe punëve ndërtimore dhe nga ana tjetër bazuar në ngritjen enorme të çmimeve sipas inflacionit ekonomik. Sipas çmimeve aktuale të tregut kostoja mesatare për realizimin e projektit me sukses dhe që mos të dështojë është rreth apo mbi 300,000.00€.

Prandaj kërkojmë nga AK që vlera e kontratës të rishqyrtohet he të përcaktohet duke u krahasuar në raport me rrethanat dhe çmimet aktuale të tregut dhe inflacionit ekonomik.

**Përgjigje në pretendimin ankimor pika e parë :**

*Sa i përket vlerës së parashikuar të kontratës prej 187,049.13 €, nga ana jonë është përcaktuar sipas vlerës reale dhe analizës financiare duke u bazuar në çmimet relevante në tregun aktual të materialit si dhe punëve ndërtimore.*

*Që do të thotë se kjo vlerë mbetet e pa ndryshuar.*

**Pretendimi ankimor të tretë :**

Në paramasën e dosjes së tenderit është specifikuar në rubrika të veçanta veç e veç materiali dhe puna. Një ndarje si kjo është e paqartë dhe e palogjikshme dhe për më tepër në praktikën e prokurimit nuk kemi hasur asnjëherë që ka ndodh.

Prandaj kërkojmë nga AK që ky përshkrim të korrigohet duke e vendosur me një rubrikë realizimin e punimeve dhe furnizimeve pasi që këto dy punë janë organikisht të lidhura njëra me tjetren dhe në praktiken e gjertanishme të aktivitetave të prokurimit duke ju përfshirë edhe juve ka qenë siç është konstatuar më lart.

**Përgjigje në pretendimin ankimor të tretë :**

*Sa i përket pikës 3 paramasa është e hartuar nga ekspertë të fushës së elektros dhe është e paraparë që të përfshij 2 fazat e projektit veç e veç (ndarja në fazë krijon lehtësira gjatë fazës së mbikëçyrrjes).*

**Pretendimi ankimor i katër :**

Ju si autoritet kontraktues në nenin 8.1-8.2 të dosjes së tenderit lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare të tenderuesve keni përcaktuar se Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 500.000,00 euro

**Përgjigje në pretendimin ankimor të katër :**

*Kemi bërë Korrigjin e DT si dhe Njostimit për Kontratë në këtë pikë. Andaj, Bazohuni tek Versioni i Korrigjuar tek DT si dhe Njostimi për Kontratë i datës 04.04.2023.*

Andaj AK duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit Po ashtu duke pasur në konsideratë nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së lidhur me mënyrën më efikase, transparente do të bejë korigimin e dosjes së tenderit konformë rregullave të prokurimit dhe LPP.

Shqipe Hoxha



Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit te Komunës;  
Te gjitha palëve te interesuara;  
Arkivit të Komunës.